



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100021/4

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandim për zbatimin e detyrimit ligjor për të paralajmëruar personat pjesëmarrës në tubim se do të përdoret forcë për shpërndarjen e tyre si dhe i parimit ligjor të proporcionalitetit kur përdoret gaz lotsjellës dhe ujë me presion (rasti i protestave të zhvilluara në Tiranë, në muajin dhjetor 2020)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHËTETIT

Tiranë

I nderuar Z. Veliu,

Sikurse jeni vënë në dijeni nga letërkëmbimi ynë i mëparshëm, Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë një hetim administrativ lidhur me përdorimin e gazit lotsjellës gjatë protestave që u organizuan në Tiranë në muajin dhjetor 2020, si reagim i qytetarëve ndaj një ngjarje të rëndë, ku i riu Klodian Rasha u qëllua me armë zjarri nga një punonjës i Policisë së Shtetit dhe për pasojë humbi jetën. Ky hetim ka nisur për të verifikuar ankesat e tre shtetasve L. K., M. K. dhe D. M., pjesëmarrëse në këto protesta, të cilat kanë shprehur shqetësimin se nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe në mënyrë më specifike gjatë protestës së datës 11 dhjetor 2020, është përdorur gaz lotsjellës pa bërë dallim ndërmjet protestuesve paqësorë, kalimtarëve të rastit apo shtetasve që kanë kryer veprime të dhunshme duke dëmtuar objekte të ndryshme. Gjithashtu, ankuesit kanë ngritur shqetësimin se ndaj qytetarëve është hedhur gaz lotsjellës, pa u njoftuar më parë me altoparlant se do të shpërndahej turma.

Vrasja e të ndjerit Klodian Rasha është një nga ngjarjet më sensitive që shënoi vitin 2020 duke shkaktuar reagimin e qytetarëve në mbarë vendin, të cilët kërkuan zbardhjen sa më parë të saj dhe vendosjen para drejtësisë të personit përgjegjës.

Në disa qytete të ndryshme të vendit u organizuan protesta për disa ditë me radhë, ku pjesëmarrës ishin kryesisht të rinj, mes tyre edhe persona jo madhorë, nën moshën 18 vjeç.

Në Tiranë, protesta ishte e shpërndarë në disa zona të qytetit, ku përveç qytetarëve që shprehnin në mënyrë paqësore qëndrimin e tyre, ka patur edhe pjesëmarrës, të cilët kryen veprime të dhunshme ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, duke i goditur ata me sende të forta, si dhe dëmtuan disa godina të institucioneve shtetërore e objekte publike.

Për këto akte institucioni i Avokatit të Popullit ka mbajtur qëndrim publik, si të papranueshme dhe të pajustificuara pavarësisht indinjatës së qytetarëve për shkak të ngjarjes së ndodhur. Në të gjitha rastet Avokati i Popullit ka bërë thirrje për ushtrimin në mënyrë paqësore të së drejtës së protestës duke kërkuar vetëpërmbytje nga të gjitha palët.

Policia e Shtetit ka ndërhyrë për të shpërndarë protestën duke përdorur forcën fizike, gaz lotsjellës dhe ujë me presion. Gjatë protestës janë shoqëruar në komisariatet e Tiranës një numër jo i vogël protestuesish.

Institucioni i Avokatit të Popullit në vijimësi ka monitoruar protestat nëpërmjet pamjeve të shfaqura në media si dhe grupeve të punonjësve që ndodheshin në terren. Gjithashtu pas përfundimit të protestave janë kryer disa vizita dhe inspektime në ambientet e strukturave të Policisë Vendore në Tiranë.

Nga ana jonë janë administruar disa pamje filmike, të cilat janë këqyrur me vëmendje për t'u shprehur lidhur me rregullsinë e veprimeve të punonjësve të Policisë së Shtetit. Gjithashtu kemi kërkuar të informohemi nga institucioni juaj¹ për sasinë e gazit lotsjellës të përdorur në protestat e zhvilluara në Tiranë, llojin e tyre dhe nëse janë lajmëruar qytetarët paraprakisht se do të përdorej kjo lëndë për t'i shpërndarë.

¹ Shkresa me nr.K2/L1-2 Prot., datë 02.02.2021.

Vlerësojmë se për strukturat e Policisë së Shtetit është një sfidë jo e lehtë për të mbarëvajtur një tubim për arsye se nga njëra anë duhet përmbushur detyra për garantimin e ushtrimit të të drejtës/lirisë themelore kushtetuese të tubimit paqësor të shtetasve dhe nga ana tjetër të sigurohet mbrojtja e rendit publik.

Liria e pjesëmarrjes në tubime paqësore është e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e II-të “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, Kreu III “Liritë dhe të drejtat politike”, respektivisht në nenin 47², neni 11 i Konvetës Europiane të të Drejtave të Njeriut³ dhe Ligji Nr.8773, datë 23.04.2001 “Për Tubimet”⁴.

Legjislacioni i cituar më lart parashikon edhe kufizimet e kësaj të drejte, në rast se rrezikohet sigurimi kombëtar, sigurimi publik, mbrojtja e rendit dhe parandalimi i krimit, ruajtja e shëndetit ose moralit, ose mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të të tjerëve. Neni 9 i Ligjit Nr.8773, datë 23.04.2001 “Për Tubimet” përcakton rastet kur një tubim mund të shpërndahet nga forcat policore.

Më konkretisht:

“1. Një tubim në një shesh ose vendkalim publik mund të shpërndahet nga forcat policore me uniformë, vetëm në rastet kur:

a) mënyra e zhvillimit të tubimit është e tillë që mund të dëmtojë në mënyrë konkrete rendin publik dhe sigurinë e personave;

b) gjatë zhvillimit të tij kryhen krime;

c) ekziston një situatë emergjente që lidhet me sigurinë publike, kur vendi i zënë nga tubimi kërkohet nga shërbimet e emergjencës”.

² Në nenin 47 të Kushtetutës parashikohet se:

“1. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar.

2. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj”.

³ Në nenin 11 të KEDNJ, shprehimisht thuhet se:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve....”.

⁴ Në Republikën e Shqipërisë çdo person ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë.

Në rast se Policia e Shtetit vendos të shpërndajë tubimin me forcë, duhet të kihen parasysh rregullat që kanë të bëjnë me përdorimin e forcës, sikurse janë:

- domosdoshmëria e përdorimit të forcës;
- shkalla e kërcënimit;
- masa e forcës;
- kohëzgjatja e saj;
- paralajmërimi për përdorimin e forcës.

Intensiteti i forcës së ushtruar nuk duhet të jetë më shumë nga sa është e nevojshme dhe të minimizohen dëmet që mund t'u shkaktohen shtetasve. Parimi i proporcionalitetit dhe i përshkallëzimit të masave shtrënguese zbatohet si në situatat kur vendoset të përdoret forcë fizike, ashtu edhe për rastet kur përdoren mjete të veçanta, siç janë gazi lotsjellës, bombula sprajt (me piper) dhe ujë me presion. Mjetet e veçanta janë pajisje që punonjësi i Policisë së Shtetit i përdor kur është e nevojshme gjatë ushtrimit të detyrës së tij⁵.

Llojet e armatimit, lëndët neuroparalizuese dhe mjete të tjera të përdorimit të forcës nga strukturat e Policisë së Shtetit, janë të miratuara me VKM Nr.293, datë 08.04.2015 “Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit”, sipas lidhjes që i është bashkëlidhur këtij vendimi. Më konkretisht, në pikën 2/b të këtij vendimi parashikohet se strukturat e Policisë së Shtetit pajisen me:

“Municione me lëndë irrituese në formë pluhuri, lëngu me përbërje CS; CN; OC; që hidhen me shotgun, me granatë dore, pajisje hedhëse, sprajt ose tubet, për mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e turmave”.

⁵ Në nenin 99 të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, parashikohet:

“1. Punonjësi i policisë ka të drejtë të mbajë armë. Llojet e armatimit, të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga policia përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Punonjësit të policisë i jepen në përdorim mjete dhe pajisje të tjera nga ato të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, të përcaktuara në Rregulloren e Policisë”.

Ndërsa, në nenin 54/1 të VKM Nr.750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit”, përcaktohet se: “1. Punonjësit e Policisë pajisen me armatim, municion e pajisje për kryerjen e detyrave të ngarkuara, sipas funksionit organik, në përputhje me ligjin “Për armët”.

Sa i përket procedurës së përdorimit të lëndëve lakrimogjene, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me Urdhrin Nr.92, datë 06.02.2015 ka miratuar Procedurën standarde “Për përdorimin e lëndëve lakrimogjene”, në pikën II të së cilës thuhet se:

“Kjo procedurë përcakton se lëndët lakrimogjene do të përdoren nga strukturat e policisë për vetëmbrojtje, në operacione policore për kapjen e personave të rrezikshëm e të armatosur që qëndrojnë në vende të mbyllura, për shpërndarje turmash të dhunshme, për neutralizimin e veprimeve të subjekteve kriminale

Pavarësisht se lëndët lakrimogjene janë jo vdekjeprurëse, punonjësit e policisë do t’i përdorin në masë të tillë që niveli i dëmtimeve të jetë sa më i vogël për jetën dhe shëndetin e personave që janë nën ndikimin e efektit të lëndëve”.

Ndërsa, në pikën IV/A/6 të Procedurës përcaktohet se:

“Drejtuesi i operacionit kur gjykon se duhet të përdoret lëndë lakrimogjene paraprakisht këshillohet me specialistin e përdorimit për sasinë e lëndës që duhet përdorur, kushtet meteorologjike, drejtimin e erës, objektet që janë më të rëndësishme ku duhet shmangur afrimi i turmës së dhunshme, vendet e rrezikshme ku nga përdorimi i lëndëve lakrimogjene mund të shkaktohen zjarre, rrugët e evakuimit etj”.

Sjellim në vëmendje se në pikën IV/C të Procedurës parashikohet përdorimi i lëndëve lakrimogjene për shpërndarjen, zhvendosjen e turmave të dhunshme në ambiente të hapura (sheshe, rrugë), gjysëm të hapura (stadium, terrene sportive të mbuluara) dhe të mbyllura (ndërtesa, shpella etj.). Më konkretisht, në pikën 1 të shkronjës C, parashikohet se:

“Përdorimi i lëndëve lakrimogjene bëhet vetëm me urdhër të drejtuesit të operacionit pasi janë konsumuar të gjitha masat paraprake dhe përdorimi i lëndëve lakrimogjene mbetet një mundësi për arritjen e qëllimit të planit operacional të miratuar, ose kur rrethanat ndryshojnë papritur dhe përdorimi i lëndëve lakrimogjene frenon rritjen e veprimeve të dhunshme ndaj forcave të policisë apo arratisjen e personit të rrethuar”.

Në disa raste që do i rendisim dhe analizojmë më poshtë⁶, çmojmë se protestuesit nuk janë lajmëruar për përdorimin e gazit lotsjellës dhe ujit me presion, ka patur përdorim të paarsyeshëm të ujit me presion si dhe nuk është marrë parasysh rreziku i përdorimit të

⁶ Pamjet filmike (videot) që na janë paraqitur nga ankueset L. K., M. K. dhe D. M., që u përkasin momenteve të kryerjes së veprimeve të punonjësve të policisë gjatë protestave.

gazit lotsjellës në një zonë me dendësi të lartë banimi. Bashkëlidhur këtij rekomandimi do të gjeni të hedhura në CD pamjet e përshkruara si më poshtë.

Episodi 1. Një turmë protestuesish është mbledhur në Bulevardin “*Dëshmorët e Kombit*”, përballë godinës së Kryeministrisë, ku janë vendosur gardh punonjës të Policisë së Shtetit dhe një automjet që lëshon ujë me presion. Për aq sa tregojnë pamjet nuk duket që protestuesit të jenë të dhunshëm, por dëgjohe vetëm disa prej tyre që bërtasin. Në një çast, pa u dhënë paralajmërim, në drejtim të turmës hidhet ujë me presion dhe gaz lotsjellës. Një pjesë e turmës, bashkë me personin që po filmon, tërhiqet në drejtim të ish-Bllokut duke kaluar nga rrugica ku ndodhet godina e Gjykatës Kushtetuese. Çmujmë se në këtë rast nuk është zbatuar detyrimi ligjor për të lajmëruar protestuesit se do të përdoret gaz lotsjellës dhe ujë me presion për shpërndarjen e tyre, në mënyrë që ata shtetas, të cilët manifestojnë në mënyrë paqësore dhe i binden autoritetit shtetëror, të kenë mundësi të largohen, pa pasoja në shëndetin e tyre.

Në nenin 133, pika 6 të Ligjit Nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*” parashikohet se:

*“6. Grupe personash paralajmërohen sa më shpejt të jetë e mundur se do të përdoret forcë ose forma e forcës së përdorur do të ndryshohet, në mënyrë që pjesëmarrësit të lejohen të largohen”. Ndërsa në nenin 23, pika 2 e Ligjit Nr.8773, datë 23.04.2001 “*Për Tubimet*” përcaktohet se: “*Në rast se pas tri thirrjeve të qarta nga ana e policisë për shpërndarje, pjesëmarrësit nuk largohen, oficeri i policisë urdhëron shpërndarjen e tubimit me forcë*”.*

Episodi 2. Në kryqëzimin e rrugëve “*Myslym Shyri*” dhe “*Ibrahim Rugova*”, ku ndodhen përreth Parku “*Rinia*” dhe godina e Ministrisë së Financave, ka të shpërndarë persona, disa prej të cilëve mund të jenë protestues. Me sa kuptohet nga pamjet filmike, qarkullimi i automjeteve është bllokuar, pasi dëgjohe boritë që bien pa ndërprerje. Punonjës të policisë, të vendosur në afërsi të murit rrethues të oborrit të Katedrales Ortodokse, hedhin gaz lotsjellës në drejtime të ndryshme të kryqëzimit, pa njoftuar më parë. Ky është një rast tjetër i dokumentuar, ku punonjësit e policisë nuk lajmërojnë se do të përdoret gaz lotsjellës, veçanërisht në dy rrugë ku ushtrojnë aktivitet tregtar një numër jo i vogël subjektësh privatë dhe ka dendësi të lartë banimi.

Episodi 3. Pamjet tregojnë se një granatë me gaz lotsjellës ka përfunduar në shkallët që çojnë në një subjekt privat, të ndodhur nën nivelin e tokës. Me shumë mundësi ky subjekt

gjendet përgjatë Rrugës “Myslym Shyri” ose Rrugës “Ibrahim Rugova”. Një shtetas afrohet për të parë nëse ka persona brenda mjedisit që është përfshirë nga gazi. Pamjet zgjasin pak sekonda dhe nuk na lejojnë të kuptojmë se çfarë ka ndodhur më tej. Ajo që kuptohet qartë është rreziku që mund të përbëjë përdorimi i gazit lotsjellës në një zonë të banuar dhe vlerësimi e rëndësia që duhet t’u jepet rregullave të parashikuara në Urdhrin Nr.92, dt. 06.02.2015 *“Për përdorimin e lëndëve lakrimogjene”*, ku citojmë edhe një herë se: *“Pavarësisht se lëndët lakrimogjene janë jo vdekjeprurëse, punonjësit e policisë do t’i përdorin në masë të tillë që niveli i dëmtimeve të jetë sa më i vogël për jetën dhe shëndetin e personave që janë nën ndikimin e efektit të lëndëve”*.

Episodi 4. Pamjet tregojnë një automjet të Policisë së Shtetit që hedh ujë me presion, e pas këtij veprimi, punonjës të policisë me veshje mbrojtëse lëvizin në Rrugën “Ibrahim Rugova”, në zonën e ish-Bllokut, në afërsi të Librit Universitar, ku më parë kanë kaluar disa protestues. Në këtë çast në trotuar ndodhen disa kalimtarë të rastit që kanë ndaluar duke parë nga punonjësit e policisë. Në drejtim të tyre dhe të personave që ndodhen në një bar kafe duke filmuar, hidhet ujë me presion. Në vlerësimin tonë në këtë rast, uji me presion është përdorur në mënyrë të paarsyeshme ndaj këtyre shtetasve, pasi nga pamjet duket qartazi se ata nuk po kryenin veprime të dhunshme, nuk po cënonin rendin dhe nuk përbënin rrezik për punonjësit e policisë.

Sjellim në vëmendjen Tuaj, se Institucioni i Avokati të Popullit në vijimësi ka monitoruar një sërë tubimesh të mbajtura në vend, ku në çdo rast kemi mbajtur qëndrimin tonë publik, duke bërë thirrje për ushtrimin në mënyrë paqësore të së drejtës së protestës e duke kërkuar vetëpërmbytje.

Protestat e mbajtura në muajin dhjetor 2020 kanë qenë spontane, të pa njoftuara më parë, si reagim i menjëhershëm ndaj ngjarjes së rëndë të vrasjes së të ndjerit Klodian Rasha nga një punonjës i policisë. Situata ka qenë dinamike, turma e protestuesve e paparashikueshme dhe disa prej pjesëmarrësve në protestë, kryesisht të rinj në moshë, të shpërndarë në pika të ndryshme të kryeqytetit, kryen veprime të dhunshme ndaj punonjësve të policisë si dhe dëmtuan pronën publike dhe atë private.

Duke vlerësuar rolin e domosdoshëm të Policisë së Shtetit për mbarëvajtjen e rendit dhe të vetëdijshëm për rrezikun që i kanoset punonjësve të policisë gjatë punës së tyre,

tërheqim vëmendjen në faktin se ata gjithashtu, duhet të respektojnë të drejtën e grumbullimit të shtetasve për të shprehur pikëpamjet e tyre si dhe të drejtat dhe liritë e të shtetasve të tjerë.

Në përgjigjet⁷ që kemi marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit gjatë trajtimit të kësaj çështjeje thuhet se: *“Gjatë përballjes me protestuesit e dhunshëm, punonjësit e policisë kanë ndjekur gjithë hapat e nevojshme për të ndaluar dhunën, duke demonstruar prezencë të dukshme të punonjësve të strukturave vendore të policisë Tiranë dhe grupeve NSH pranë institucioneve shtetërore, duke bërë thirrje me megafon, dhe kur kanë pasur të pamundur ndalimin e dhunës së protestuesve, kanë përdorur taktika e mjete speciale të certifikuara për menaxhimin e situatës”*. Në protestat e mbajtura në Tiranë janë përdorur gjithsej 467 granata⁸ me gaz lotsjellës.

Lidhur me efektet e gazit lotsjellës, në një informacion të mëparshëm të Policisë së Shtetit thuhet se: *“Lëndët e përdorura nuk dëmtojnë shëndetin. Ato kanë efekt irritues në rrugët e frymëmarrjes dhe shkaktojnë lot, konfuzion dhe çorientim të turmës, për të ulur motivimin dhe kapacitetet e saj për të kryer veprime të dhunshme”*.

Megjithëse gazi lotsjellës cilësohet si një mjet jovdekjeprurës dhe përdoret për të shpërndarë protestues të dhunshëm në një mënyrë më të sigurtë, përsëri ekziston mundësia e lëndimit të personave. Gazi lotsjellës ndikon në mënyrë të ndryshme tek fëmijët, gratë shtatzënë dhe të moshuarit. Niveli i intoksimit mund të ndryshojë nga sasia e përdorur dhe kohëzgjatja e ekspozimit ndaj tij. Pamjet që kemi administruar gjatë këtij hetimi administrativ tregojnë se, në disa raste gazi lotsjellës është përdorur pa lajmëruar më parë protestuesit, pa marrë në konsideratë pasojat që mund të shkaktojë tek protestuesit paqësorë, shtetasit që kanë qenë duke marrë shërbime të ndryshme pranë subjekteve privatë apo kalimtarët e rastit në zonat e sipërpërmendura me dendësi banimesh dhe në episodin 1, qartazi në dukje, pa patur provokim ndaj punonjësve të policisë. Qasja për të parandaluar dhunën, para se ajo të ndodhë, duke përdorur mjete si ujë me presion apo gaz lotsjellës, shpesh mund të rezultojë një taktikë që ndez tension në vend që të vendosë rregull.

⁷ Shkresat me Nr. 521/1 Prot., datë 22.01.2021 dhe Nr.521/3 prot., datë 08.02.2021.

⁸ Granatat janë të llojit: G303-CSS; G717-STCS; MP-40MB-CS.

Sa u përket detyrimeve thelbësore të autoriteteve shtetërore, ata kanë një detyrë pozitive për të lehtësuar dhe mbrojtur ushtrimin e së drejtës/lirisë së tubimit paqësor. Kjo detyrë duhet të pasqyrohet në kuadrin legjislativ, si dhe rregulloret dhe praktikrat përkatëse të zbatimit të ligjit. Detyra për të mbrojtur përfshin gjithashtu mbrojtjen e organizatorëve dhe pjesëmarrësve të protestës nga individë ose grupe të palëve të treta që kërkojnë të minojnë të drejtën e tyre për lirinë e tubimit paqësor.⁹ Veçanërisht duhet të përmenden tre lloje specifike të mbledhjeve: Kundër protestat; protestat e njëkohshme si dhe protestat spontane dhe jo të njoftuara.

Dispozitat ligjore që mbulojnë lirinë e tubimit paqësor duhet të jenë mjaft të qarta për t'i dhënë mundësi çdo individi të vlerësojë nëse veprimet e tij mund të shkelin ligjin si dhe të dijë pasojat e mundshme të ndonjë shkeljeje të tillë. Legjislacioni i hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut është jetik për përcaktimin dhe kufizimin e kompetencave dhe diskrecionit të autoriteteve publike dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit. Në thelbin e interpretimit të standardeve të të drejtave të njeriut qëndron parimi i përgjithshëm që të drejtat e njeriut do të gëzohen pa asnjë diskriminim.

Lidhur me përshkallëzimin e situatës në dhjetor 2020, qëndrim publik ka mbajtur edhe Komisioneri i Lartë i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, Znj. Dunja Mijatovic, e cila ndër të tjera është shprehur se: *“Autoritetet shqiptare duhet të tregojnë përmbajtje në menaxhimin policor të demonstratave dhe të sigurojnë hetime të hollësishme, të pavarura dhe efektive për të gjitha pretendimet e përdorimit të tepruar të forcës. Ndërsa e drejta për mbledhje paqësore mund të kufizohet për të mbrojtur shëndetin publik, autoritetet duhet të mbështesin parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit në të gjitha rrethanat. Policia gjithashtu duhet të bëjë dallimin midis individëve të përfshirë në dhunë dhe atyre që demonstronë në mënyrë paqësore dhe të përmbahen nga përdorimi i rëndë ose pa kriter i forcës.”*¹⁰ Në këtë kontekst, ajo ka sjellë në vëmendje edhe përdorimin e automjeteve me ujë, sprajit me piper apo mjeteve të tjera që kanë çuar në plagosjen e disa protestuesve.

⁹ *Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly*, Doc. CDL-AD(2019)017, OSCE/ODIHR & Venice Commission, 8 July 2019.

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)017-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)017-e)

¹⁰ Për më tepër, mund të shihet Deklarata e plotë e datës 16.12.2020 *“Albanian authorities must prevent further police violence and uphold the right to freedom of peaceful assembly”*.

<https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/albanian-authorities-must-prevent-further-police-violence-and-uphold-the-right-to-freedom-of-peaceful-assembly>

Gjithashtu, Komisioneri i Lartë i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut ka ritheksuar që policimi i demonstratave duhet të bazohet në komunikim dhe bashkëpunim me organizatorët dhe pjesëmarrësit në demonstrata dhe duhet të synojë në uljen e përshkallëzimit të tensioneve.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*".

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat kompetente të Policisë së Shtetit për analizimin me objektivitet dhe profesionalizëm të veprimeve të kryera nga disa punonjës të policisë për rastet në të cilët kanë hedhur pa paralajmërim dhe në mënyrë joproporcionale gaz lotsjellës dhe ujë me presion ndaj disa kalimtarëve dhe shtetasve pjesëmarrës në protestat e dhjetorit 2020.
2. Fillimin e ecurisë disiplinore, identifikimin e punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje ligjore ndaj qytetarëve protestues dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete ndaj tyre.
3. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat kompetente të Policisë së Shtetit për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive mbarëvajtjes së tubimeve si të njoftura më parë ashtu edhe atyre që organizohen në mënyrë spontane.
4. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat kompetente të Policisë së Shtetit për përgjithësimin e këtij rasti, me qëllim përdorimin në të ardhmen të gazit

lotsjellës, ujit me presion dhe mjeteve të tjera në përputhje me të gjitha rregullat dhe procedurat e parashikuara që kanë të bëjnë me përdorimin e forcës.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi